

Trafiku hekurudhor

Neni 59

1. Shoqëria hekurudhore që pranon të fusë me rrugë hekurudhore në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë hekurudhore mallra
38 të shoqëruara me një dokument dorëzimi, është organi përgjegjës për kryerjen e formaliteteve doganore përkatëse.
2. Shoqëria hekurudhore vë në dispozicion të Administratës Doganore gjithë dokumentat e mbajtura pranë zyrës së financës, në lidhje me mallrat e transportuara.
3. Në transportin e udhëtarëve me rrugë hekurudhore, autoritetet doganore kryejnë të gjitha kontrollet në pikat e kalimit të kufirit tokësor hekurudhor mbi udhëtarët dhe bagazhet e tyre, si edhe në kabinën e drejtimit, mbi personelin dhe bagazhet e tij.